

# Lëshimi i vizave të qëndrimit, tip D

## Përshkrimi

Pajisja e shtetasve të huaj me vizë qëndrimi tip D, për të aplikuar për leje qëndrimi në Shqipëri.

## Dokumentacioni i nevojshëm

- 1) Formulari i aplikimit
- 2) Foto për pasaportë, jo më e vjetër se 6 muaj
- 3) Fotokopje e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit, me vlefshmëri së paku 3 muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar
- 4) Sigurimi shëndetësor për gjithë kohëzgjatjen e vizës
- 5) Për fëmijët nën 18 vjeç: deklaratë ku shprehet pëlqimi i prindit ose i kujdestari ligjor për udhëtimin e fëmijës, ose personi që e ka në ngarkim.
- 6) Për vize të tipit D/AE/AP/AT/APU kërkohen dhe:
  - Ftesa nga subjekti pritës së bashku me kopjen e tij të identitetit
  - Dokumentet që provojnë veprimtarinë profesionale me të cilën lidhen motivet e kërkesës
  - Fotokopje e lejes së punës lëshuar nga autoritetet shqiptare
  - Në rastin e subjektit tregtar, dokumentet që provojnë statusin juridik
- 7) Për vize të tipit D/ST kërkohen dhe:
  - Dokumenti që provon regjistrimin në një institucion arsimor
  - Garanci që vërteton mbulimin e shpenzimeve të jetesës dhe shkollimit
  - Dokumenti i sigurimit shëndetësor për kohëzgjatjen e qëndrimit
  - Dokumentin që vërteton strehimin
  - Dokumenti mbi njohjen e gjuhës me të cilën do të kryhen studime.
- 8) Për vizë të tipit D/BF duhet edhe:
  - Fotokopja e dokumentit të identifikimit të pritësit (kur pritësi është shtetas i huaj duhet edhe fotokopja e lejes së qëndrimit)
  - Certifikatë familjare të muajit të fundit që vërteton lidhjen e personit që kërkon bashkim familjar
  - Dokumente shtesë që provojnë lidhjen e qëndrueshme me personin që kërkon bashkim familjar
  - Dokumente që provojnë se pritësi i huaj ka kushte të përshtatshme për banim
  - Fotokopje e noterizuar e dokumentit që provon se pritësi i huaj është i punësuar apo i vetëpunësuar dhe ka të ardhura të mjaftueshme për të siguruar jetën e personave që pret.
- 9) Për vizë të tipit D/VHF duhet edhe:
  - Fotokopje e noterizuar të licencës së ushtrimit të veprimtarive humanitare
  - Fotokopje e lejes së punës ose certifikatës së regjistrimit për punë
  - Deklaratë për motivin e punës nga subjekti i bashkësisë fetare
- 10) Për vizë të tipit D/DS duhet edhe:
  - Nota verbale nga institucioni
  - Ftesën nga institucioni pritës
- 11) Për vizë D/PS duhet edhe:
  - Ftesë nga subjekti pritës
  - Fotokopje e noterizuar të kontratës së punës me pritësin
  - Fotokopje e lejes së punës lëshuar nga autoritetet shqiptare
  - Dokumenti i cili provon regjistrimin e të huajit në institucionet e vendit të origjinës
- 12) Për vizë të tipit D/H duhet edhe:

- Dokumente që provojnë motivet humanitare

### Hapat e procedurës

- 1) Paraqitja personale (të paktën kur kryen për herë të parë aplikimin)
- 2) Plotësimi i formularit të vizës. Për fëmijët plotësimi i formularit të vizës për fëmije bëhet nga njëri ose dy prindërit, ose kujdestari ligjor ose personi që e ka në ngarkim
- 3) Paraqitja personale për marrjen e vizës

### Tarifa e shërbimit dhe afati

- 1) Me reciprocitet, në bazë të VKM 513/13;
- 2) Pa pagesë:
  - Fëmijët deri 6 vjeç;
  - Mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit;
  - Anëtarët e organizatave jofitimprurëse nën 25 vjeç;
  - Nxënësit e shkollave, studentët, studentët pasuniversitare për motive studimi ose trajnimi arsimor;
  - Studiues që kryejnë kërkime shkencore;
  - Raste humanitare;
- 3) Fëmijët nga 6-12 vjeç sa gjysma e tarifave të vizave për të rritur

Afati i vlerësimit të kërkesës zgjat deri 15 ditë dhe për raste përjashtimore zgjat deri në 30 ditë.

### Zyra

Të gjitha përfaqësitë diplomatike dhe konsullore

### Shënime

Marrja e vizës nuk është garanci që të huajit t'i lejohet hyrja në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet kur fëmijët nuk kanë pasaportë, viza shënohet në vizën e prindit ose të kujdestarit ligjor, në pasaportën e të cilit është shënuar.

Pas refuzimit të vizës i huaji ka të drejtë të riaplikojë vetëm pasi të ketë mbyllur procedurën e apelimit ose pasi të kenë kaluar tre muaj nga data e marrjes së vendimit për refuzim.

[Formulari për aplikimin për vizë](#)